



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 812 / Prot.
2

Vlorë, më 3.03.2025

VENDIM

Nr. 19, datë 03.03.2025

**PËR
MIRATIMIN E FORMATIT TË ÇERTIFIKATËS PËR AKORDIMIN E TITULLIT
"PROFESOR EMERITUS"**

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19 pika 1, gërma dh të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr.112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "professor i asociuar" dhe "profesor"" kreu V, pika 1, si dhe referuar Vendimit Nr.36, datë, 23.09.2024 "Për miratimin e Rregullores për akordimin e titullit Profesor Emeritus", referuar propozimit të Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve ardhur me shkresë 803, prot, datë 28.02.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 03.03.2025

VENDOSI:

1. Të miratojë formatin e çertifikatës për akordimin e titullit "Profesor Emeritus", sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi
2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj